



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 270, datë 04.12.2019

PËR
REFUZIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES {...}
PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenit 24 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 132/1 të Kodit të Punës së R.Shqipërisë, Vendimit nr. 72 datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, mbi kërkesën e gjyqtares {...},

V E N D O S I :

1. Refuzimin e kërkesës së {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}, për dhënie leje të papaguar për periudhën 7 Dhjetor 2019 deri në 30 Prill 2020.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR